BASHKIA MA
Zyra e Protokollit
Nr. 592 Prot
Date 06.02.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Korçë, më 30.01.2026

SHPALLJE VENDIMI

Drejtuar : Njesia Administrative Pojan Bashkia Maliq

Për shtetasen Lida Shoshari me adrese : Pojan Njesia Administrative Pojan Bashkia Maliq

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr. 809 dt. 27.10.2025 te Gjykates se Shkalles se Pare te Juridikisonit te Pergjithshem Korce, për t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor,* pasi deftesa e komunikimit eshte kthyer me shenimin " larguar ..." dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Geralda Kasuli

U afishua sot në datë ----------
Per : Njesia Administrative Pojan Bashkia Maliq

(emër, mbiemër, firmë)

32

- Nj.A. Pojan
- STIHP
dt 06.02.2026

Scanned with CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Nr. Regj. Them. 21001-00412-41-2025 (1423) **Nr. vendimi 41-2025-3455 (809)**
Datë Regjistrimi 14.04.2025 **Datë vendimi 27.10.2025**

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

"Për pushimin e gjykimit"

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, e përbërë nga **gjyqtari i vetëm:**

ESTJON VENXHA

asistuar nga sekretare gjyqësore **Zamira Shkëmbi,** në Korçë, sot më datë **27.10.2025,** mori në shqyrtim, në seancë pergatitore, çështjen civile-familjare nr. regj. them. 21001-00412-41-2025 (1423), datë 27.10.2025 regjistrimi, me palë:

Paditëse: **Lida Shoshari,** e bija e Alket dhe Djana, e datëlindjes 20.05.1996, lindur në Bilisht, Bashkia Devoll dhe banuese në Pojan, Nj.Adm. Pojan, Bashkia Maliq, me shtetësi shqiptare, e martuar, me fëmijë të mitur, identifikuar me letërnjoftimin ID me nr. personal J65520036C.

I paditur: **Ilir Shoshari,** i biri i Shazhiman dhe Kimete, i datëlindjes 28.01.19994, lindur dhe banues në Bilisht, Bashkia Devoll, rr. "Jani Karanxha", Nd.4, H.1, me shtetësi shqiptare, i martuar, mbajtës i dok. të identifikimit me nr. personal J40128029M (në mungesë, **njoftuar me shpallje publike**).

Objekti: Kërkoj zgjidhjen e martesës ligjore të datës 30.07.2014, lënien e fëmijes Merjem Shoshari, të datëlindjes 5.10.2023 mua për rritje e edukim. Detyrimin e të padituri për të paguar një pension ushqimor për të në masën 15,000 lekë në muaj.

Baza ligjore: Neni 132, 154 e vijues i Kodit te Familjes.

Gjykata, në seancën përgatitore të datës së sotme, pasi verifikoi paraqitjen e palëve,

Konstatoi se:

I. Procedura.

1. Pranë kësaj gjykate është regjistruar kërkesëpadia, me palë dhe objekt si më sipër. Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të padisë, gjykata analizoi juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e çështjes dhe në bazë të neneve 36 (1), 349 dhe 51 dhe 59 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata konstatoi se çështja hyn në juridiksionin

Scanned with CamScanner

gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë. Në bazë të nenit 35 të KPC kjo çështje u gjykua nga një gjyqtar. Gjithashtu gjykata, në vështrim të neneve 71, 72 dhe 73 të KPC, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar nga palët ndërgjyqëse.

2. Në referim të dispozitave materiale dhe procedurale të Kodit të Familjes, gjykata caktoi fillmisht seancën e pajtimit, duke njoftuar palët ndërgjyqëse për t'u paraqitur personalisht, me qëllim realizimin e kësaj seance konform nenit 134 dhe 135 të Kodit të Familjes. Në seancën e pajtimit u paraqit vetëm pala paditëse, ndërsa pala e paditur nuk është paraqitur edhe pse prezumohet marrja dijeni e tij e rregullt për gjykimin, nga njoftimi me shpallje publike.

3. Në zbatim të nenit 134 dhe135 të K.Familjes, gjykata bëri të gjitha përpjekjet e saj për pajtimin e palëve. Gjykata, pasi dëgjoi vetëm palën paditëse në seancë pajtimore, krijoi bindjen se vullneti i saj (paditëses) për zgjidhjen e marteses ishte real dhe i lirë dhe se, nuk kishte asnjë mundësi pajtimi, pasi marrëdhëniet midis palëve ishin tronditur deri në atë masë sa e bënin të pamundur jetesën e tyre të përbashkët. Po në këtë seancë, në kushtet kur nga martesa midis palëve ndërgjyqëse, ka ardhur në jetë fëmija e mitur Merjem Shoshari e datëlindjes 05.10.2023, nga ana e gjykatës, në zbatim të nenit 224/a të KPC dhe neneve 6, 155 dhe 157 të KF, në kushtet kur për sqarimin e rrethanave të faktit kërkoheshin njohuri të posaçme në fushën e psikologjisë, është vendour kryerja e një ekspertimi psikologjik dhe caktimi i një eksperte psikologe, konkretisht psikologe Marjola Jano. Rrjedhimisht, me qëllim caktimin e detyrave për eksperten (dhe realizimin e betimit) gjykata vendosi kalimin e çështjes në seancë përgatitore.

Ndërkohë pala paditëse bëri me dije se, fëmija e mitur Merjem Shoshari edhe pse figuron me baba të padituri Ilir Shoshari, në fakt ky i fundit nuk është ati biologjik i fëmijës. Në këto rrethana, gjykata *i la kohë paditëses* për të vlerësuar nëse kjo e fundit kërkon të vijojë me gjykimin për zgjdhjen e martesës apo duhet të iniciojë procesin gjyqësor për kundërshtimin e atësisë së prezumuar.

4. Në seancën e sotme përgatitore të datës 27.10.2025, në zbatim të nenit 175 të KPC gjykata verifikoi paraqitjen e palëve dhe rezultoi se, asnjë prej palëve ndërgjyse nuk është paraqitur në gjykim. Në lidhje me palën paditëse, kjo e fundit ka patur dijeni të rregullt për datën dhe orën e gjykimit pasi ka qenë e pranishme në seancën e kaluar përgatitore. Sektretaria gjyqësore ka komunikuar nëpërmjet telefonit me av. Enina Face (e deklaruar nga paditësja si përfaqësuese e saj) dhe kjo e fundit ka bërë me dije padinë me objekt zgjidhje martese do t'a depozitojnë në një moment të mëvonshëm *pasi të zgjidhet çështja e atësisë së fëmijës së mitur.* Në lidhje me të padituri Ilir Shoshari, sikurse u citua më sipër, njoftimi është kryer nëpërmjet shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 133/a e vijues të KPC.

II. Analiza juridike.

5. Në kushtet e mësipërme, gjykata **vlerëson se duhet të vendoset pushimi i gjykimit** pasi ekzistojnë kriteret e përcaktuara në nenet 179/1 dhe 229/ç të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata evidenton se, vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën, përveç kur ligji parashikon ndryshe (neni 2 i KPC). Parimi i iniciativës së palëve u njeh të drejtën palëve për të kërkuar fillimin e një procesi gjyqësor dhe për të disponuar në lidhje me padinë në mënyrë individuale.

Neni 179 parag. 1 i KPC i titulluar "Pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve" parashikon se: *"...1. **Nëse asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë***

Scanned with CamScanner

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenet 179/1, 299 gërma "ç" dhe nenin 301 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI

1. Pushimin e gjykimit që i përket çështjes civile me nr. 1423 Akti., datë 14.04.2025 regj., me palë paditëse Lida Shoshari, të paditur Ilir Shoshari dhe objekt zgjidhje martese etj.
2. Shpenzimet gjyqësore lihen në ngarkim të palës paditëse.
3. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 5 ditëve, duke filluar afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar

U shpall në Korçë sot më datë 27.10.2025

SEKRETARE
ZAMIRA SHKËMBI

GJYQTAR
ESTJON VENXHA

Tabela e shpenzimeve
Taksë regjistrimi: 3,000 Lekë
Njoftime 6x130: 780 Lekë
Total: 3,780 Lekë.

14-01-2026

RR 801 576 670 AA

Scanned with CamScanner

***përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit** 2.Nëse paditësi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur i padituri nuk ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes. Kur i padituri e ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes, mund të kërkojë vijimin e gjykimit në mungesë të paditësi dhe gjykata, kur vlerëson se qëndrimi i palës së paditur ka shkak të ligjshëm, vijon gjykimin në mungesë të paditësit (...)".* Ndërsa në nenin 299/ç të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se gjykata vendos për pushimin e gjykimit kur pushimi parashikohet shprehimisht në ligj.

6. Kodi i Procedurës Civile rregullon mosparaqitjen e palëve në seancë përgatitore ose gjyqësore në nenin 179/1 dhe 2 të tij. Një nga rastet në të cilat ligji ka parashikuar shprehimisht pushimin e gjykimit është mosparaqitja e palëve pa shkaqe të arsyeshme edhe pse ka dijeni nga akti i njoftimit apo për shkak të prezencës në seancën paraardhëse (neni 179/1 dhe 2 i KPC).

Kështu, sipas nenit 179/1 dhe 2 të KPC gjykata vendos pushimin e gjykimit për mosparaqitjen e palës paditëse kur plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte të domosdoshme, konkretisht: (i) të paturit dijeni nga ana e paditësit për datën dhe orën e zhvillimit të seancës përgatitore ose gjyqësore; (ii) mosparaqitja e palës në seancën e caktuar, pa ndonjë shkak të arsyeshëm[1] për të cilën gjykata duhet të vihet në dijeni paraprakisht; (iii) duke patur në konsideratë qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese[2] dhe Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë[3], *gjykata verifikon fazën në të cilën ndodhet gjykimi,* si dhe *sjelljen në vazhdimësi të palës paditëse/kërkuese,* në drejtim të faktit nëse ai ka shfaqur interes për çështjen.

7. Në rastin konkret, gjykata vëren se përmbushen të gjitha kushtet ligjore për të vendosur pushimin e gjykimit nisur nga mosparaqitja e palës paditëse, për shkak se: **Së pari,** paditësja Lida Shoshari ka patur dijeni të rregullt për datën dhe orën e gjykimit pasi ka qenë e pranishme në seancën e kaluar përgatitore; **Së dyti,** pala paditëse nuk referoi ndonjë shkak të arsyeshëm përmes të cilave të justifikohet mosparaqitja. **Së treti,** gjykata verifikoi fazën në të cilën ndodhet gjykimi, si dhe sjelljen në vazhdimësi të palës paditëse. Konkretisht gjykata mban parasysh faktin se, përfaqësuesja e paditëses ka komunikuar nëpërmjet sekretarisë se, padinë me objekt zgjidhje martese do t'a depozitojnë sërish në një moment të mëvonshëm **pasi të zgjidhet çështja e atësisë të fëmijës së mitur.**

8. Për sa më sipër, bazuar në nenin 179/1 si dhe nenin 299/ç, të Kodit të Procedurës Civile, gjykata çmon se në rastin konkret duhet të vendosë pushimin e gjykimit për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse në seancë përgatitore pa ndonjë shkak të përligjur.

9. Në referim të neneve 301, 443 dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile kundër vendimit me të cilin vendoset pushimi i gjykimit lejohet ankim i veçantë, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, afati i cili është 5 (pesë) ditë dhe nis të llogaritet nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

10. Së fundmi, duke qenë se vendoset pushimi i gjykimit të padisë për shkak të mosparaqitjes së paditësit, në zbatim të neneve 102-106 të K. Pr. Civile, gjykata vlerëson se shpenzimet gjyqësore duhet të lihen në ngarkim të palës paditëse

---

[1] Neni 175/2 i KPC përcakton se, në rast se, mosparaqitja ka ndodhur për shkak **sëmundjeje ose për ndonjë shkak tjetër të ligjshëm,** gjykata shtyn gjykimin për një ditë tjetër.
[2] Shih vendimin nr. 68, datë 08.10.2024 të Gjykatës Kushtetuese.
[3] Shih vendimin nr. 00-2024-4895 (825), datë 11.12.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Scanned with CamScanner